



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Nr. i Dokumentit: 24.22.1-2017-08

RAPORTI I AUDITIMIT
PËR PASQYRAT FINANCIARE VJETORE TË AUTORITETIT
RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
PËR VITIN E PËRFUNDUAR MË 31 DHJETOR 2017

Prishtinë, qershor 2018

Zyra Kombëtare e Auditimit e Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, i cili me Kushtetutën dhe ligjet e vendit gëzon pavarësi funksionale, financiare dhe operative. Zyra Kombëtare e Auditimit kryen auditime të rregullsisë dhe të performancës dhe për punën e vet i jep llogari Kuvendit të Kosovës.

Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të fuqizojmë llogaridhënien në administratën publike për përdorimin efektiv, efikas dhe ekonomik të burimeve kombëtare.

Ne kryejmë auditime në përputhje me standardet e njohura ndërkombëtare të auditimit në sektorin publik si dhe me praktikatat e mira evropiane.

Raportet e Zyrës Kombëtare të Auditimit promovojnë drejtpërsëdrejti llogaridhënien e institucioneve publike pasi që ato ofrojnë bazë të qëndrueshme për të kërkuar llogari nga menaxherët e çdo organizate buxhetore. Në këtë mënyrë ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike.

Auditori i Përgjithshëm ka vendosur në lidhje me opinionin e auditimit për Pasqyrat Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit, në konsultim me Ndihmës Auditorin e Përgjithshëm Valbon Bytyqi, e cili e ka mbikëqyrur auditimin.

Raporti është rezultat i auditimit të kryer nga Udhëheqësi i ekipit Sabile Musa dhe Anëtarët Mazlumsha Sejfadini dhe Shqiponja Krasniqi, nën menaxhimin e Udhëheqësit të Departamentit të Auditimit Faruk Rrahmani.

TABELA E PËRMBAJTJES

Përmbledhje e përgjithshme	4
1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit	6
2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm	7
3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli	10
4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve.....	14
5 Qeverisja e mirë.....	15
Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA	17
Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga dy vitet paraprake	20
Shtojca III: Letërkonfirmimi	23

Përmbledhje e përgjithshme

Hyrje

Ky Raport përmbledh çështjet kryesore që dalin nga auditimi i Pasqyrave Financiare Vjetore të Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin 2017, i cili e përcakton Opinionin e dhënë nga Auditori i Përgjithshëm. Ekzaminimi i pasqyrave financiare për vitin 2017 është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit. Qasja jonë ka përfshirë testet dhe procedurat, të cilat ishin të nevojshme për të arritur në një opinion lidhur me pasqyrat financiare. Qasja e aplikuar e auditimit është paraqitur në Planin e Jashtëm të Auditimit, të datës 07/05/2018.

Auditimi ynë është fokusuar në:



Puna e ndërmarrë nga Zyra Kombëtare e Auditimit për të përfunduar auditimin për vitin 2017 është përcaktuar varësisht nga cilësia e kontrollit të brendshëm të zbatuar nga menaxhmenti i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit.

Zyra Kombëtare e Auditimit vlerëson Menaxhmentin e lartë dhe stafin e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për bashkëpunim gjatë procesit të auditimit.


Opinion i Auditorit të Përgjithshëm

Opinion i kualifikuar

Sipas opinionit tonë, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin 2017 *paraqesin një pamje të drejtë dhe të vërtetë* në të gjitha aspektet materiale, përveç nënvlerësimit të buxhetit për paga dhe mëditje për 10,539€.

Më gjerësisht shih Pjesën 2.1 të këtij Raporti.

Shtojca I, shpjegon llojet e ndryshme të opioneve të aplikuara nga Zyra Kombëtare e Auditimit.

Konkluzionet dhe rekomandimet kryesore**Përgjigja e Drejtorit**

Drejtori i Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit ka marrë në konsideratë dhe është pajtuar me të gjeturat e detajuara dhe konkluzionet e auditimit, si dhe është zotuar se do t'i adresojë të gjitha rekomandimet e dhëna.

1 Fushëveprimi dhe metodologjia e auditimit

Hyrje

Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) është përgjegjëse për kryerjen e auditimit të rregullsisë që përfshin ekzaminimin dhe vlerësimin e pasqyrave financiare dhe të dhënave tjera financiare, si dhe dhënien e opinionit:

- Nëse pasqyrat financiare japin një pamje të drejtë dhe të vërtetë të llogarive dhe çështjeve financiare për periudhën e auditimit;
- Nëse të dhënat financiare, sistemet dhe transaksionet janë në pajtim me ligjet dhe rregulloret në fuqi;
- Për përshtatshmërinë e funksioneve të kontrollit të brendshëm dhe të auditimit të brendshëm; dhe
- Për të gjitha çështjet të cilat dalin apo kanë të bëjnë me auditimin.

Puna e ndërmarrë e auditimit është bazuar në vlerësimin e rrezikut për auditimin e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU). Ne kemi analizuar veprimtarinë e ARRU-së se deri në çfarë mase mund të mbështetemi në kontrollet menaxheriale për të përcaktuar nivelin e testeve të hollësishme, që janë të nevojshme për të siguruar dëshmitë që mbështesin opinionin e Auditorit të Përgjithshëm.

Seksionet e mëposhtme ofrojnë një përmbledhje më të detajuar të gjetjeve tona të auditimit, me theks të veçantë në vëzhgimet dhe rekomandimet në çdo fushë të rishikimit.

Procedurat tona kanë përfshirë rishikimin e kontroleve të brendshme, të sistemeve të kontabilitetit, teste të ndërlidhura substanciale si dhe aranzhimet e ndërlidhura të qeverisjes deri në masën që ne i konsiderojmë të nevojshme për kryerjen efektive të auditimit. Të gjeturat e auditimit nuk duhet të konsiderohen si një pasqyrë gjithëpërfshirëse e të gjitha dobësive që mund të ekzistojnë, apo e të gjitha përmirësimeve që mund të bëhen në sistemet dhe procedurat që kanë operuar.

2 Pasqyrat financiare vjetore dhe obligimet e tjera për raportimin e jashtëm

Hyrje

Auditimi ynë i Pasqyrave Financiare Vjetore (PFV) të ARRU-së merr parasysh pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë dhe saktësinë e informacionit të prezantuar në PFV. Gjithashtu merret parasysh edhe deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe Zyrtari Kryesor Financiar, kur PFV-të dorëzohen në Ministrinë e Financave.

Deklarata për prezantimin e PFV-ve përfshinë një numër të pohimeve në lidhje me pajtueshmërinë me kornizën raportuese si dhe cilësinë e informacionit në kuadër të PFV-ve. Këto pohime kanë për qëllim t'i ofrojnë Qeverisë sigurinë se të gjitha informatat relevante u janë ofruar për të siguruar se mund të ndërmerret një proces auditimi.

2.1 Opinioni i auditimit

Opinioni i kualifikuar

Ne kemi audituar PFV-të e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, të cilat përfshijnë pasqyrën e pranimeve dhe të pagesave në para të gatshme, pasqyrën e ekzekutimit të buxhetit, shpalosjet dhe raportet tjera përcjellëse.

Sipas opinionit tonë, përveç efekteve të çështjes së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Pasqyrat Financiare Vjetore për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017, prezantojnë një pamje të drejtë dhe të vërtetë në të gjitha aspektet materiale, në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit për Sektorin Publik (sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme), Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063) dhe Rregulloren MF, Nr. 01/2017 për raportim vjetor financiar nga organizatat buxhetore.

Baza për opinion të kualifikuar

Në Pasqyra Financiare Vjetore te Raporti i ekzekutimit të buxhetit, te kolona e buxhetit final është prezantuar gabimisht vlera prej 348,195€. Sipas Sistemit Informativ për Menaxhimin e Financave të Kosovës (SIMFK) kjo vlerë është 358,734€ e që nënkupton se buxheti final ishte nënvlerësuar për 10,539€. Arsyeja për këtë gabim është se ARRU për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ka marrë për bazë raportin e alokimeve për përgatitjen e PFV-ve për 2017. Për këtë arsye ne kemi kualifikuar opinionin tonë.

Auditimi jonë është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA). Sipas këtyre standardeve, përgjegjësitë tona janë përshkruar më poshtë tek

pjesa 'Përgjegjësitë e Auditorit për Auditimin e Pasqyrave Financiare'. Sipas kërkesave etike, të cilat janë relevante për auditimin tonë të pasqyrave vjetore financiare të organizatave buxhetore, ZKA është e pavarur nga ARRU dhe përgjegjësitë tjera etike janë përmbushur në pajtim me këto kërkesa. Besojmë se dëshmitë e auditimit që kemi marrë janë të mjaftueshme dhe të duhura për sigurimin e bazës për opinionin tonë të kualifikuar.

Përgjegjësia e menaxhmentit dhe personave të ngarkuar me qeverisje për PFV

Drejtori i ARRU-së është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e drejtë të pasqyrave financiare sipas Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik - Raportimi Financiar bazuar në Kontabilitetin e Parasë së Gatshme të modifikuar si dhe është përgjegjës për kontrolle të brendshme të cilat menaxhmenti i përcakton si të nevojshme për të mundësuar përgatitjen e pasqyrave financiare, pa keq-deklarime materiale të shkaktuara qoftë nga mashtrimi apo gabimi. Kjo përfshinë zbatimin e Ligjit nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063).

Drejtori i ARRU-së është përgjegjës për të siguruar mbikëqyrjen e procesit të raportimit financiar të ARRU-së.

Përgjegjësia e Auditorit të Përgjithshëm për auditimin e PFV-ve

Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion për PFV në bazë të auditimit të kryer. Auditimi është kryer në përputhje me SNISA. Këto standarde kërkojnë që t'i përmbahemi kërkesave etike, të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin për të marrë siguri të arsyeshme se pasqyrat financiare nuk përmbajnë keq-deklarime materiale.

Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë i sigurisë, por nuk garanton se një auditim i kryer në pajtim me SNISA-t do të zbuloj çdo keq-deklarim material që mund të ekzistoj. Keq-deklarimet mund të rezultojnë nga mashtrimi ose gabimi dhe konsiderohen materiale nëse, individualisht ose së bashku, mund të ndikojnë në vendimet e marra mbi bazën e këtyre PFV-ve.

Auditimi përfshinë kryerjen e procedurave për të marrë dëshmi në lidhje me informatat financiare dhe shpalosjet në PFV. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, duke përfshirë edhe vlerësimin e rreziqeve nga keq-deklarimet materiale në PFV, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit. Gjatë vlerësimit të rrezikut, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm që është relevant në përgatitjen e pasqyrave financiare nga entiteti, në mënyrë që të dizajnoj procedura të auditimit që janë të përshtatshme për rrethanat e entitetit, por jo për qëllim të shprehjes së opinionit mbi efektivitetin e kontrolleve të brendshme të entitetit.

Auditimi përfshinë edhe vlerësimin e përshtatshmërisë së politikave kontabël të përdorura, arsyeshmërinë e përlllogaritjeve kontabël të bëra nga menaxhmenti, si dhe vlerësimin e prezantimit të pasqyrave financiare.

2.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim

ARRU kërkohet të raportoj në përputhje me kornizën e caktuar raportuese dhe kërkesat tjera për raportim. Ne kemi marrë parasysh:

- Pajtueshmërinë me Rregulloren MF. Nr. 01/2017 për Raportim Vjetor Financiare nga Organizatat Buxhetore;
- Kërkesat e LMFP-së nr. 03/L-048 (i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Nr. 04/L-116, Nr. 04/L-194 dhe Ligjin Nr. 05/L-063);
- Pajtueshmërinë me Rregullën Financiare nr. 01/2013 dhe 02/2013;
- Planin e veprimit për adresimin e rekomandimeve;
- Planin përfundimtar të Prokurimit; dhe
- Kërkesat e Procedurave të Menaxhimit Financiar dhe të Kontrolleve.

Përveç çështjes së përshkruar në paragrafin Baza për Opinion të Kualifikuar, Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, me rastin e dorëzimit të PFV-ve në Ministrinë e Financave, konsiderohet e plotë dhe e saktë në të gjitha aspektet materiale.

Në kontekst të kërkesave tjera për raportim të jashtëm, nuk kemi çështje për të ngritur.

2.3 Rekomandimet lidhur me Pasqyrat Financiare Vjetore

Rekomandimi 1 Drejtori i ARRU-së duhet të siguroj se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Kualifikim të opinionit. Veprime specifike duhet të ndërmerren për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike me qëllim të eliminimit të gabimeve në prezantimin e informatave në PFV. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar, nuk duhet të nënshkruhet përveç nëse ndaj PFV-të janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme.

3 Menaxhimi financiar dhe kontrolli

Hyrje

Puna jonë lidhur me Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin (MFK), pasqyron aktivitetet e detajuara të auditimit për sistemet e të hyrave dhe shpenzimeve në organizatat buxhetore. Në mënyrë të veçantë, në fokus të auditimit ishte menaxhimi i buxhetit, çështjet e prokurimit, burimet njerëzore, pasuritë dhe detyrimet.

Konkluzioni për menaxhimin financiar dhe kontrollin

Në kontekst të sistemeve financiare, kontrollet mbi shpenzimet dhe të hyrat në përgjithësi janë të përshtatshme dhe janë duke u zbatuar. Megjithatë kontrollet mbi menaxhimin e pasurive lidhur me zhvlerësimin, kërkojnë përmirësim të mëtejshëm.

3.1 Planifikimi dhe realizimi i buxhetit

Ne i kemi shqyrtuar burimet e fondeve buxhetore, shpenzimet e fondeve si dhe të hyrat e arkëtuara sipas kategorive ekonomike. Kjo është paraqitur në tabelat e mëposhtme:

Tabela 1. Burimet e fondeve buxhetore (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final ¹	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Burimet e Fondeve:	358,734	358,734	332,564	304,579	292,008
Granti i Qeverisë -Buxheti	358,734	358,734	332,564	304,579	292,008

Buxheti final në raport me buxhetin fillestar nuk kishte ndryshime. Në vitin 2017, ARRU ka shpenzuar 93% të buxhetit final me një nën shpenzim prej 6% krahasuar me vitin 2016.

Tabela 2. Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Realizimi	2016 Realizimi	2015 Realizimi
Shpenzimet e fondeve sipas kategorive ekonomike:	358,734	358,734	332,564	304,579	292,008
Pagat dhe Mëditjet	217,736	217,736	207,197	186,970	177,792
Mallrat dhe Shërbimet	134,495	134,495	121,990	113,610	109,329
Shërbimet komunale	6,503	6,503	3,377	3,999	4,887

¹ Buxheti Final - buxheti i aprovuar nga Kuvendi i përshtatur më pas nga Ministria e Financave.

Shpjegimet rreth ndryshimeve në kategoritë buxhetore janë dhënë si në vijim:

- Në përgjithësi realizimi i buxheti për kategori ekonomike ishte në nivel të kënaqshëm me përjashtim: buxheti për shërbime komunale nuk ishte realizuar në përqindje më të lartë nga fakti që buxheti i ndarë ishte më i lartë se sa nevojat si pasojë e pamundësisë që të planifikohet saktë për komunalit.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.2 Të hyrat

Të hyrat e realizuara nga ARRU në 2017 ishin në vlerë prej 352,784€. Ato kanë të bëjnë me Licencimin e Kompanive Regjionale të Ujërave (KUR). Kompanitë e licencuara janë të obliguara të paguajnë taksën vjetore të licencimit në dymbëdhjetë këste të barabarta për çdo muaj.

Tabela 3. Të hyrat vetjake (në €)

Përshkrimi	Buxheti fillestar	Buxheti Final	2017 Pranimet	2016 Pranimet	2015 Pranimet
Të hyrat vetjake	360,037	360,037	352,784	187,412	336,989
Totali	360,037	360,037	352,784	187,412	336,989

Të hyrat e arkëtuara transferohen në Buxhetin e Kosovës (BK). Totali i të hyrave të arkëtuara reflekton një rritje dukshëm më të lartë krahasuar me vitet paraprake. Kjo rritje është rezultat i licencimit të KUR-ve për tërë vitin, derisa për vitin 2016 kishte ngecje në këtë drejtim për shkak të mos emërimit të menaxhmentit të ARRU-së nga Kuvendi i Kosovës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.3 Pagat dhe shtesat

Pagat paguhen përmes një sistemi të centralizuar të pagesave që menaxhohet nga MAP dhe MF. Sipas shënimeve të SIMFK-së, buxheti për kategorinë e pagave dhe mëditjeve ishte 217,736€, ndërsa realizimi i shpenzimeve ishte 207,197€.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.4 Menaxhimi i personelit

Numri i planifikuar i stafit ishte 21, numri aktual në dhjetor të vitit 2017 ishte 18. Procedurat e rekrutimit ishin zhvilluar dhe në vitin 2018, pritet plotësimi i vendeve të lira të punës.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.5 Mallrat dhe shërbimet, si dhe shërbimet komunale

Buxheti final për mallra dhe shërbime përfshirë shërbimet komunale në vitin 2017 ishte 140,998€. Prej tyre ishin shpenzuar 125,366€. Ato kanë të bëjnë me: shpenzime të udhëtimit, furnizim për zyre, naftë për ngrohje qendrore e kryesisht shpenzime të qirasë për ndërtesë.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.6 Pasuritë kapitale dhe jo-kapitale

Vlera neto e pasurive e shpalosur në PFV ishte 23,302€. Prej tyre vlera e pasurive kapitale ishte 1,329€, pasuri jokapitale ishin 19,544€, dhe vlera e stoqeve ishte 2,429€.

Ne kemi rishikuar nëse procesi i regjistrimit dhe mënyra e mbajtjes së evidencave është në pajtueshmëri me kërkesat e rregullës së MF-Nr. 02/2013 për menaxhimin e pasurive jo financiare në organizatat buxhetore, procesin e inventarizimit, zhvlerësimin dhe ekzistencën fizike të pasurive.

Çështja 2 – Sistemi “e-pasuria” me mangësi në kalkulimin e zhvlerësimit

E gjetura	ARRU ka filluar të aplikoj sistemin “e-pasuria” për regjistrim të pasurive nën 1,000€ nga muaji korrik 2017. Brenda vitit 2017 ARRU kishin regjistruar pasuritë jo kapitale në sistemin e-pasuria, mirëpo ne kemi vërejtur se nuk ishte duke u kalkuluar zhvlerësimi për këto pasuri. ARRU kishte komunikuar me MAP-in për rregullimin e çështjes së zhvlerësimit por nuk ishte ndërmarrë ndonjë veprim.
Rreziku	Mos zhvlerësimi i pasurisë sipas normave të rregullores 02/2013 për menaxhimin e pasurive rezulton me mbivlerësim të pasurive neto dhe prezantim jo të saktë të vlerës neto të pasurive në PFV.
Rekomandimi 2	Drejtori i ARRU-së duhet të shtoj kontrollin në menaxhimin e pasurive, duke siguruar që zhvlerësimi i pasurive bëhet në pajtim me rregulloren në fuqi, në mënyrë që të mundësohet raportim i saktë i vlerës së pasurive neto në PFV.

3.7 Të Arkëtueshmet

Vlera e llogarive të arkëtueshme në fund të vitit 2017 ishte 426,537€, prej tyre 7,254€ i përkasin vitit 2017 kurse 419,283€ janë të arkëtueshmet e bartura nga vitet paraprake. Ato kanë të bëjnë kryesisht me të arkëtueshmet e papaguara nga kompanitë regjionale për mbeturina dhe që janë në procese gjyqësore.

Rekomandimet

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

3.8 Obligimet e papaguara

Pasqyra e detyrimeve të papaguara ndaj furnitorëve në fund të vitit 2017 ishte 1,395€, prej tyre 1,084€ ishin obligime të papaguara nga kategoria e mallrave dhe shërbimeve, ndërsa 311€ për shërbime komunale. Këto detyrime janë bartur për t'u paguar në vitin 2018. Obligimet e papaguara kanë mbetur për shkak se faturat janë pranuar me vonesë.

Rekomandimet

Ne nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

4 Progresi në zbatimin e rekomandimeve

Raporti ynë i auditimit për PFV-të e vitit 2016 ka rezultuar me tetë rekomandime kryesore. ARRU kishte përgatitur planin e veprimit ku kishte paraqitur afatet dhe mënyrën se si do t'i zbatoj rekomandimet e dhëna.

Deri në fund të auditimit tonë për vitin 2016, pesë rekomandime janë zbatuar, dy ishin në proces të zbatimit dhe një nuk ishte zbatuar. Rekomandimi për hartimin e regjistrit të rrezikut, pyetësorin e vetëvlerësimit dhe raportimit menaxherial ishin bartur nga viti 2015. Këto rekomandime në vitin 2017 ishin zbatuar dhe rekomandimi për PFV është i bartur dhe mbetet i pazbatuar.

Për një përshkrim më të plotë të rekomandimeve dhe mënyrën se si janë trajtuar ato, shihni Shtojcën II.

Çështja 3 – Zbatimi i rekomandimeve nga dy vitet paraprake

- | | |
|----------------------|---|
| E gjetura | Edhe përkundër progresit dhe angazhimit të menaxhmentit për të zbatuar rekomandimet e dhëna, kanë mbetur ende në proces të zbatimit ose të pazbatuara rekomandimet që ndërlidhen me informatat e paraqitur në PFV dhe menaxhimin e pasurive. |
| Rreziku | Përmirësimet e kërkuara të proceseve operacionale që nuk po zbatohen rezultojnë në përsëritjen e mangësive nga vitet paraprake dhe ndikojnë në mos efikasitet të vazhdueshëm drejt arritjes së objektivave të përcaktuara. |
| Rekomandimi 3 | Drejtori i ARRU-së duhet të siguroj që po zbatohet plani i veprimit, i cili i përcakton saktë afatet kohore për zbatimin e rekomandimeve të bëra nga Auditori i Përgjithshëm, me stafin përgjegjës të identifikuar, duke u fokusuar fillimisht në fushat më të rëndësishme. |

5 Qeverisja e mirë

Hyrje

Qeverisja e mirë nënkupton parimet themelore të llogaridhënies, efektivitetin e kontrolleve, menaxhimin e rreziqeve, pavarësinë e auditimit të brendshëm, koordinimin e ZKA-së me auditimin e brendshëm dhe qeverisjen e mirë me pasuritë publike.

Tregues kyç në mbështetje të qeverisjes efektive është zbatimi i rekomandimeve të auditimit pasi kjo tregon se në çfarë mase menaxhmenti po ndërmerr veprime për t'i përmirësuar proceset ekzistuese dhe kontrollet. Niveli i përmbushjes së kërkesave të MFK-së nga ana e organizatave buxhetore po monitorohet edhe nga plotësimi i pyetësorëve të vet-vlerësimit që plotësohet nga të gjitha OB-të, të cilat në fund të vitit i dorëzohen Ministrisë së Financave. Fusha të veçanta të rishikimeve tona lidhur me qeverisjen kanë qenë procesi i llogaridhënies dhe menaxhimi i rreziqeve, ndërsa komponentat tjera janë trajtuar në brendi të kapitujve apo nënkaptujve të mësipërm të raportit.

Konkluzioni i përgjithshëm mbi qeverisjen

ARRU në përgjithësi ka kontrolle të mira në raport me obligimet ligjore të saj. Menaxhimi financiar dhe kontrolli ka dëshmuar proces të mirë të rishikimit dhe siguri në zbatimin e legjislacionit dhe proceseve të tjera të kontrollit.

Disa aspekte të qeverisjes brenda ARRU-së kërkojnë të përmirësohen, veçanërisht në lidhje me menaxhimin e pasurive. ARRU ka zbatuar pjesën më të madhe të rekomandimeve si dhe ka përgatitur regjistrin e rreziqeve me të gjitha masat, duke identifikuar të gjitha rreziqet domethënëse që mund të kenë ndikim tek organizata në lidhje me arritjen e objektivave të saj.

5.1 Sistemi i auditimit të brendshëm

Sipas UA Nr. 23/2009 për themelimin dhe funksionimin e Njesisë së Auditimit të Brendshëm (NJAB), ARRU nuk i plotëson kriteret për themelimin e kësaj njësie.

Rekomandime

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

5.2 Raportimi menaxherial, llogaridhënia dhe menaxhimi i rrezikut

Për të pasur një planifikim të mirë, për të mbikëqyrë aktivitetet në baza të rregullta dhe për të mundësuar vendimmarrje efektive, menaxhmenti ka nevojë të posedoj raporte të rregullta. Llogaridhënia si proces është pranim i përgjegjësive, mbajtja e personave përgjegjës për veprimet e tyre dhe shpalosje e rezultateve në mënyrë transparente. Ndërsa, menaxhimi i rrezikut është një proces që ka të bëjë me identifikimin, analizën, vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmentit për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që kërcënojnë organizatën.

Menaxhmenti, ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet. Linjat e llogaridhënies dhe të komunikimit ishin funksionale përmes raporteve dhe takimeve të rregullta.

Rekomandimi

Nuk kemi rekomandime në këtë fushë.

Shtojca I: Shpjegim i llojeve të ndryshme të opinioneve të aplikuara nga ZKA

(e shkëputur nga ISSAI 200)

Forma e opinionit

147. Auditori duhet të japë një **opinion të pa-modifikuar** nëse arrin në përfundimin se pasqyrat financiare janë përgatitur, në të gjitha aspektet materiale, në pajtim me kornizën e zbatueshme financiare.

Nëse auditori, bazuar mbi dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë keq-deklarime materiale ose nuk arrin të marrë dëshmi të mjaftueshme auditimi për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale, atëherë ai duhet të modifikojë opinionin në raportin e auditorit sipas pjesës që flet për 'Përcaktimin e llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit'.

148. Nëse pasqyrat financiare të përgatitura sipas kërkesave të një kornize për prezantim të drejtë nuk arrijnë të japin një paraqitje të drejtë, auditori duhet të diskutojë çështjen me menaxhmentin dhe, varësisht nga kërkesat e kornizës së zbatueshme për raportim financiar dhe nga mënyra se si zgjidhet çështja, të përcaktojë nëse është e nevojshme të modifikojë opinionin e auditimit.

Modifikimet që i bëhen opinionit në raportin e auditorit

151. Auditori duhet të modifikojë opinion në raportin e auditorit në rast se, duke u bazuar në dëshmitë e marra të auditimit, arrin në përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi përmbajnë gabime materiale, ose në qoftë se auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të nxjerrë përfundimin se pasqyrat financiare si tërësi nuk përmbajnë keq-deklarime materiale. Auditorët mund të japin tri lloje opinionesh të modifikuara: opinion të kualifikuar, opinion të kundërt dhe mohim të opinionit.

Përcaktimi i llojit të modifikimit që i bëhet opinionit të auditorit

152. Vendimi se cili lloj i opinionit të modifikuar është i përshtatshëm varet nga:

- natyra e çështjes që i jep shkas modifikimit – d.m.th nëse pasqyrat financiare përmbajnë keqdeklarime materiale ose, në rast se ishte e pamundur për të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, mund të përmbajnë keqdeklarime materiale; dhe
- gjykimi i auditorit rreth përhapjes së efekteve ose efekteve të mundshme që çështja ka në pasqyrat financiare.

153. Auditori duhet të japë një **opinion të kualifikuar nëse**: (1) pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë materiale por nuk janë përhapur në pasqyrat financiare, ose (2) nëse auditori nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, por arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë materiale por jo të përhapura.

154. Auditori duhet të japë një **opinion të kundërt nëse**, pasi ka marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme, auditori arrin në përfundimin se keqdeklarimet, ose individualisht ose së bashku, janë edhe materiale edhe të përhapura në pasqyrat financiare.

155. Auditori duhet japë **mohim të opinionit nëse**, pasi nuk ka mundur të marrë dëshmi auditimi të mjaftueshme dhe të përshtatshme në të cilat të bazojë një opinion, auditori arrin në përfundimin se efektet e çdo gabimi të pazbuluar mbi pasqyrat financiare kanë mundur të jenë edhe materiale edhe të përhapura. Nëse, pas pranimit të angazhimit, auditori bëhet i vetëdijshëm se menaxhmenti ka imponuar një kufizim të fushëveprimit të auditimit, për të cilin auditori konsideron se mund të rezultojë në nevojën për të shprehur një opinion të kualifikuar ose mohim opinionit mbi pasqyrat financiare, auditori duhet të kërkojë nga menaxhmenti ta heqë atë kufizimin.

156. Nëse auditori jep një opinion të modifikuar, ai duhet të modifikojë edhe titullin për të korresponduar me llojin e opinionit i shprehur. ISSAI 1705 jep udhëzime shtesë rreth gjuhës specifike që duhet përdorur kur jepet një opinion dhe për të përshkruar përgjegjësinë e auditorit. Ajo gjithashtu përfshin shembuj ilustrues të raporteve.

Paragrafët e Theksimit të Çështjes dhe paragrafët e Çështjeve të Tjera në raportin e auditorit

157. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për të tërhequr vëmendjen e përdoruesve në një çështje të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila është sa e rëndësishme aq edhe thelbësore që ata të kuptojnë pasqyrat financiare, por ka prova të mjaftueshme e të përshtatshme se çështja nuk përmban keqdeklarime materiale në pasqyrat financiare, auditori duhet të përfshijë një paragraf të Theksimit të Çështjes në raportin e tij. Paragrafët për Theksimin e Çështjes duhet t'i referohen vetëm informacionit të paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare.

158. Një paragraf i theksimit të çështjes duhet:

- të përfshihet menjëherë pas opinionit;
- të ketë titullin 'theksim i çështjes' ose ndonjë titull tjetër të përshtatshëm;
- të përmbajë një referencë të qartë ndaj çështjes që theksohet dhe të tregojë se në ç'pjesë të pasqyrave financiare mund të gjenden shpalosjet relevante që e përshkruajnë plotësisht çështjen; dhe
- të tregojë se opinionit i auditimit nuk është modifikuar për sa i përket çështjes të theksuar.

159. Nëse auditori e konsideron të nevojshme për ta komunikuar një çështje, përveç atyre që janë paraqitur ose shpalosur në pasqyrat financiare, e cila, në gjykimin e auditorit, është e rëndësishme për përdoruesit në mënyrë që ta kuptojnë auditimin, përgjegjësitë e auditorit apo raportin e auditimit, dhe me kusht që kjo nuk është e ndaluar me ligj ose rregullore, duhet të përpilohet një paragraf me titullin "Çështje Të Tjetra", apo ndonjë titull tjetër të përshtatshëm. Ky paragraf duhet të paraqitet menjëherë pas opinionit dhe pas çdo paragrafi të Theksimit të Çështjes.

Shtojca II: Progresi në zbatimin e rekomandimeve nga dy vitet paraprake

Komponenta e Auditimit	Rekomandimet e bartura nga viti 2015	Të zbatuara gjatë vitit 2017	Në proces të zbatimit gjatë 2017	Të pa zbatuara
1.3 Pajtueshmëria me kërkesat për PVF dhe kërkesat tjera për raportim	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet lidhur me klasifikimin e shpenzimeve dhe shpalosjet e duhura në PVF. Deklarata e bërë nga ZKA dhe ZKF nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PVF janë aplikuar të gjitha kontrollet e nevojshme apo rishikimet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.4. Lista kontrolluese e vetëvlerësimit	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është zbatuar një rishikim për plotësimin e listës kontrolluese të vetëvlerësimit dhe që është bërë adresimi i fushave me dobësi përkatësisht vlerësimin e rrezikut dhe raportimit	Po		
2.5.1 Vlerësimi i rrezikut	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është deleguar përgjegjësia e drejtpërdrejtë për menaxhimin e rrezikut tek një zyrtar përkatës dhe të sigurojë raportim mujor për zbatimin e kërkesave në këtë fushë dhe për rreziqet që janë duke u menaxhuar.	Po		
2.5.2 Raportimi Menaxherial	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme.	Po		

Komponenta e auditimit	Rekomandimet e dhëna në vitin 2016	Të zbatuara	Në proces të zbatimit	Të pa zbatuara
1.2 Pajtueshmëria me kërkesat për PFV-të dhe kërkesat tjera për raportim	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është bërë një analizë për t'i përcaktuar shkaqet për Theksim të Çështjes. Duhet të ndërmerren veprime për t'i adresuar shkaqet në mënyrë sistematike dhe pragmatike për t'i hequr gabimet në prezantimin e vlerave të raportuara në PFV-të 2017. Edhe aspektet tjera të pajtueshmërisë gjatë përgatitjes së PVF-ve duhet të adresohen. Deklarata e bërë nga Zyrtari Kryesor Administrativ dhe ai Financiar nuk duhet të dorëzohet përveç nëse ndaj draft PFV-ve janë aplikuar të gjitha kontrollet dhe rishikimet e nevojshme.			Nuk janë marrë masa.
2.1 Progresi në zbatimin e rekomandimeve të vitit paraprak	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë që plani i veprimit, rishikohet, duke analizuar shkaqet e rekomandimeve të pazbatuara, dhe të përcaktojë një afat të ri kohor, si dhe stafin llogaridhënës për zbatimin e tyre. Në fokus fillestar duhet të jenë fushat e një rëndësie më të madhe. Zbatimi i këtij plani duhet të monitorohet në vazhdimësi.		Përkundër progresit në zbatimin e rekomandimeve, disa rekomandime kanë mbetur në proces të zbatimit.	
2.2 Pyetësi i vetëvlerësimit të komponentëve të MFK-së	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është rishikuar plotësisht i pyetësorit të vetëvlerësimit dhe është bërë adresimi i fushave me dobësi në mënyrë pro aktive. Duhet të aplikohet një mekanizëm për ta konfirmuar saktësinë e pyetësorit me dokumentacionin mbështetës.	Po		
2.3 Rishikimet specifike të qeverisjes	Drejtori i Përgjithshëm duhet të përcaktojë se pse monitorimi i KRU-ve nuk ka qenë efektiv dhe të ndërmarrë veprimet e duhura për të siguruar aplikim të drejtë dhe të vazhdueshëm të tarifave të KRU-ve ndaj konsumatorëve. Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i zbatojë procedurat e përcaktuara pas paralajmërimit në përputhje me afatet ligjore.	Po		

2.3.2 Raportimi menaxherial dhe llogaridhënia	Drejtori i Përgjithshëm duhet të sigurojë se është kryer një rishikim për të përcaktuar formën e raportimit financiar dhe operativ tek menaxhmenti i lartë, nga i cili kërkohet që të mbështesë menaxhimin efektiv të veprimtarisë dhe të sigurojë se është vendosur një zgjidhje e përshtatshme deri më 1 tetor 2017.	Po		
3.1.1 Të hyrat	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i identifikojë mekanizmat efektiv që parandalojnë operimin e KRU-ve pa licenca dhe t'i vendos kontrollet për zbatim të plotë të tyre. Kjo mund të përfshijë informimin e Kuvendit të Kosovës për nevojën e emërimit me kohë të pozitës së Drejtorit të Përgjithshëm. Raportimet/harmonizimet mujore me Thesarin duhet të kryhen në baza të rregullta për të siguruar pajtueshmëri me Rregulloren dhe që vlerat e të hyrave janë të sakta dhe të plota.	Po		
3.1.2 Pagat dhe mëditjet	Drejtori i Përgjithshëm duhet t'i rishikojë arsyet e mosrealizimit të rekrutimeve dhe të sigurojë se janë ndërmarrë veprime për të adresuar çështjet e ngritura, si dhe për të shmangur pengesat e tilla në të ardhmen. Po ashtu duhet ta rishikojë pozicionin e Zyrtarit Certifikues brenda institucionit për të siguruar pavarësinë dhe funksionimin e tij sipas kërkesave mbi MFK-në.	Po		
3.2 Pasuritë	Drejtori i Përgjithshëm në bashkëpunim me Ministrinë e Administratës Publike duhet t'i analizoj arsyet e mospërdorimit të sistemit e-pasuria dhe të shqyrtojë nevojën e trajnimeve të stafit për të siguruar se regjistrimi dhe menaxhimi i pasurisë bëhet në përputhje me kërkesat e Rregullores.		ARRU ka filluar të aplikoj sistemin e-pasuria në korrik të vitit 2017, mirëpo ende ka probleme me zhvlerësimin e pasurive.	

Shtojca III: Letërkonfirmimi



Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo

AUTORITETI RREGULLATOR PËR SHËRBIMET E UJIT
REGULATORNI AUTORITET ZA USLUGE VODE
WATER SERVICES REGULATORY AUTHORITY



REPUBLIKA E KOSOVES-REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit Regulatorni Autoritet za Usluge Vode Water Services Regulatory Authority	
No. postësor / Post No.	430
Këmbëdhënja / Seal	D
No. shkronje Anglisht / English No.	
Data / Date	11.06.2018

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me të gjeturat e Auditorit të Përgjithshëm në Raportin e auditimit për vitin 2017 dhe për zbatimin e rekomandimeve

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Të nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kam pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit për auditimin e Raportit/Pasqyrave Financiare të Autoritetit Rregullator të Shërbimeve të Ujit, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2017 (në tekstin e mëtejme "Raporti");
- pajtohem me të gjeturat dhe rekomandimet dhe nuk kam ndonjë koment për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t'ju dorëzoj një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.



Z. Raif Preteni, Drejtor i ARR U

Data: 11 qershor 2018, Prishtinë,